

77



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE & JSI/ P-A

Nr. 1750 Prot.

Tiranë, më 12.12.2024

URDHËR

Nr. 61, datë 12/12/2024

“PËR DITËT E PUSHIMIT TË FESTAVE ZYRTARE TË KRISHTLINDJVE DHE VITIT TË RI, PËR PERSONELIN ADMINISTRATIV/NDIHMËS AKADEMIK/ AKADEMIK DHE STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Mbështetur në nenin 39 (Rektori) të ligjit nr. 80, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329/12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, ligjin, nr. 7961, datë 12.07. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë“ i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 06/10/2021 “Për miratimin e rregullave dhe kohëzgjatjes së punës dhe të pushimit.....”, në strukturën vjetore të procesit mësimor të vitit akademik 2024 – 2025 si dhe kalendarit të Festave Zyrtare, në cilësinë e titullarit të institucionit,

URDHËROJ:

1. Me rastin e festave zyrtare “Krishtlindjet”, bazuar në VKM cituar më lart, data 25 Dhjetor 2024 është ditë pushimi;
2. Me rastin e festave zyrtare “Vitet të ri”, bazuar në VKM cituar më lart, data 01/01/2025 dhe data 02/01/2025 janë ditë pushimi;
3. Personeli ndihmës akademik në fakultete menaxhohet nga Dekani i fakultetit me grafik, për ofrimin e shërbimeve në fakultete;
4. Stafi akademik dhe studentët sipas strukturës mësimore cituar më lart (pushimet dimërore), data 23/12/2024 deri më 03/01/2025 (14 ditë) janë ditë pushimi;
5. Ngarkohet gjithë struktura e UART, për zbatimin e këtij Urdhëri;
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli